



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05-393
Podujevë,
12.12.2016

Bazuar në nenin 20 pika 1, të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, i datës 29/08/2011, neni 23 të Ligjit për arsimin dhe aftësimin profesional nr. 04/L-138, i datës 28/02/2013, neni 5, pika d e Ligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, të datës 21/05/2008 dhe Udhëzimit Administrativ i MASHT_it për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit edukativo – arsimor dhe aftësues nr. 08/2014, të datës 25/02/2014, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Podujevës, shpall:

KONKURS

Për drejtorë dhe zëvendës drejtorë në Shkollat fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të lartë

Drejtor në SHMLE “Isa Boletini” Podujevë;
Zëvendës drejtor në SHMLE “Isa Boletini” Podujevë;
Zëvendës drejtor në gjimnazin “Aleksandër Xhuvani” Podujevë;
Drejtor në SHFMU “Dëshmorët e Kombit” Podujevë;
Drejtor në SHFMU “Enver Maloku” Podujevë;
Drejtor në SHFMU “Luigj Gurakuqi” Batllavë;
Drejtor në SHFMU “Kadri Kadriu” Llaushë;
Drejtor në SHFMU “Kongresi i Manastirit” Gllamnik;
Drejtor në SHFMU “Hamit Sejdiu” Kërpimeh;
Drejtor në SHFMU “Hyzriu e Samiu” Letanc;
Drejtor në SHFMU “Sami Frashëri” Zhiti;
Zëvendës drejtor në SHFMU “Naim Frashëri” Podujevë.

Kushtet që duhet t’i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs:

1. Kandidatët e interesuar për të konkurruar për vendet e punës drejtor dhe zëvendës drejtor duhet t’i plotësojnë këto kushte:
 - 1.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës
 - 1.2. Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4vite të shkollimit universitar) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit, sipas Udhëzimit për licencimin e

- mësimdhënësve dhe Normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore.
2. Të kenë të përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim i cili duhet të jetë i autorizuar nga Ministria sipas rekomandimeve nga KSHLM_ja;
 3. Të kenë më së paku tre vjet përvojë pune në arsim ose institucione të arsimit;
 4. Të posedojnë këto dokumente :
 - 4.1. Certifikatën e lindjes;
 - 4.2. Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës;
 - 4.3. Dëshmi për përvojën e punës;
 - 4.4. Portfolion profesionale (sipas shtojcës G të Udhëzimit administrativ i MASHT_it për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësuese nr. 08/2014, të datës 25/02/2014);
 - 4.5. Letër referencë nga një institucion publik – kredibil (si MASHT, DKA, Këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të larët);
 - 4.5.1. Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake;
 - 4.6. Planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues për të cilin konkurren (së paku 10 faqe, teksti me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12 arial) sipas udhëzimeve të MASHT_it;
 - 4.7. Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor, me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
 - 4.8. Dëshminë se nuk është nën hetime.

Detyrat e punës:

Të planifikojë, organizojë dhe bashkërendisë punën në shkollë. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, MASHT-in merr vendime të ndryshme që kanë të bëjnë me funksionimin e punës në shkollë.

Kohëzgjatja:

Periudha kohore e kontratës zgjatë 4 (katër) vjet.

Afati i konkursit 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e shpalljes së konkursit në tabelën e shpalljeve të objektit të komunës, në mediat e shkruara dhe në ueb faqen e komunës së Podujevës <http://kk.rks-gov.net/podujeve>.

Dokumentet dorëzohen në Qendrën e shërbimit për qytetarë në objektin e komunës – zyra nr. 14.

Dokumentet e pakompletuar dhe ato që arrijnë pas afatit nuk shqyrtohen.

Secili konkurrues dorëzon kopjen e vërtetuar të diplomës – dokumentet e shkollimit.

Për të gjitha vendet e punës mbahen intervista dhe orari i intervistimit shpallet në tabelën e shpalljeve në hyrje të objektit të komunës.

